



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE  
DEPARTAMENTI I HISTORI-GJEOGRAFISË**

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Elbasan, më 20.02.2024

**Lënda: Tematika e testimit me shkrim për pranimin në programin e ciklit të tretë të studimit “Doktoratë në albanologji”**

**Profil: Studime historike**

**1. Histori antike e botës:**

- Kolonizimi grek, kolonitë greke në Iliri dhe Epir.
- Pushtimi i Mesdheut nga Roma, pushtimi i Ballkanit.
- Roma dhe provincat romake.
- Ekonomia romake gjatë Republikës; Ekonomia romake gjatë Perandorisë.

**2. Histori mesjetë**

- Kristianizmi, mosmarrëveshjet doktrinore.
- Monarkizmi i krishterë.
- Ekspansioni ushtarak i Karlit të Madh.
- Shpallja e Perandorisë Karolinge.
- Kryqëzata IV dhe krijimi i Perandorisë Latine.
- Franca në fillim të shek. XIV.
- Monarkia dhe parlamenti në Angli.
- Sistemi i shteteve rajonale italiane.

**3. Histori e shqiptarëve (Histori e Shqipërisë 1)**

- Origjina e ilirëve dhe formimi i etnosit ilir.
- Shtrirja gjeografike e ilirëve dhe fiset ilire
- Qyteti e shteti ilir (Shtetet ilire)
- Ekonomia e ilirëve, zhvillimi ekonomik i qyteteve ilire, këmbimi e tregtia, monedhat ilire.

#### **4. Histori Shqipërie 2**

- Programi i Rilindjes Kombëtare Shqiptare.
- Shkaqet e Krizës Lindore të viteve '70 dhe orientimi i politikës shqiptare në këtë kohë.
- Si u konkretizua politika antishqiptare në Traktatin e Shën Stefanit dhe Kongresin e Berlinit, reagimi i politikës shqiptare.
- Interpretimi i domosdoshmërisë së ndryshimit të strategjisë dhe platformës së rilindasve pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
- Analizë e situatës arsimore dhe kulturore në Shqipëri në fillim të shek. XX dhe masat e marra për zgjidhjen e problematikave që paraqiteshin.
- Argumentim i ndryshimit të kërkesave politike të shqiptarëve në periudhën tetor-nëntor 1912.
- Kuvendi i Vlorës, vendimet e tij mbi organizimin shtetëror.

#### **5. Histori Shqipërie 3**

- Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, vendimet mbi Shqipërinë e shqiptarët, statusin e shtetit shqiptar dhe çështjen e kufijve veriorë e jugorë.
- Ardhja e Princ Vudit në Shqipëri. Kryengritja e Shqipërisë së Mesme. Rrymat në gjirin e saj dhe pasojat e krijuara.
- Lufta e Parë Botërore dhe Shqipëria.
- Jeta politike shqiptare e viteve 1920-1924. Parlamentarizimi, pluralizmi zhvillimi i ideve liberal-demokrate.
- Kriza qeveritare e dhjetorit 1921, kryengritja e Marsit 1922, pasojat mbi shtetin shqiptar.
- Përpjekjet e Ahmet Zogut në drejtim të krijimit të shtetit ligjor në dy etapat qeverisësë të Republikës Parlamentare dhe Monarkisë Parlamentare Shqiptare. Hapat dhe reformat e ndërmara në administratë, shoqëri, arsim, reforma agrare, aspekti financiar. Njohja ndëkombëtare, paktet e nënshkruara me Italinë.
- Lufta e Dytë Botërore dhe Shqipëria (qëndresa antifashiste, Krijimi i PKSH-së, Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, programet, bashkëpunimet dhe shkëputja e madhe, Mbledhja e Mukjes)
- Çlirimi i vendit. Zgjedhjet për legitimimin e pushtetit, hapat e para të liberalizimit të politikës pas Çlirimt.
- Arsimi në Shqipëri në vitet 1945-1990.
- Orientimi drejt Bllokut Lindor. Politikat e ndjekura dhe anëtarësimi në organizmat e bllokut.
- Politika e jashtme e shtetit shqiptar në vitet 1945-1990. (Marrëdhëni me Jugosllavinë, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën)
- Ndryshimet politike në vend në vitin 1990 si rrjedhojë e ndryshimeve që ndodhën në vendet e Evropës Juglindore, shembjes së Murit të Berlinit.

## **6. Histori e sotme e Botës**

- Treguesit themelore që karakterizuan Revolucionin e Dytë Industrial. Rrjedhojat kryesore të zhvillimit të tij.
- Kuptimi mbi sistemin e qeverisjes së demokracisë liberale (fillimi i shek XX)
- Përpjekjet për demokraci që u evidentuan në vendet me traditë autoritariste të sistemit qeverisës.
- Kriza e Marokut dhe e Gadishullit Ballkanik në vitet 1900-1914. Pasojat që sollën.
- Përbajtja e krizës ndërkombëtare të verës së vitit 1914. Fillimi i Luftës së Parë Botërore dhe përgjegjësit realë të shpërthimit të saj.
- Origjina e lindjes dhe trumfit të fashizmit në Itali dhe nazizmit në Gjermani. Paralele, specifika.
- Tiparet e përbashkëta dhe të veçanta që rezultojnë si rrjedhojë e krahasimit të dy lufrave botërore.
- Kuptimi mbi Luftën e Ftohtë dhe karakteristikat e zhvillimit të saj në vitet '50-'80 të shek. XX.
- Argumentimi i procesit historik të krijimit të OKB-së.

**Drejtuese e departamentit**

**Prof. dr. Rudina Mita**

